

Prezantim pranë Këshillit Konsultativ “Qeveri Qendrore – Vetëqeverisje Vendore”, të
Strategjisë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit 2024 – 2030

Më datë 11, tetor 2023, Zëvendësministri i Drejtësisë z. Klajd Karameta mori pjesë në Këshillin Konsultativ “Qeveri Qendrore – Vetëqeverisje Vendore”, të udhëhequr nga z. Arbjan Mazniku, Ministër i Shtetit për Pushtetin Vendor.

Gjatë fjalës së tij, z. Karameta bëri një pasqyrim të Strategjisë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit 2024 - 2030, ku ndër pikat që ai preku ishte angazhimi dhe rëndësia e përfshirjes së vetëqeverisjes vendore në këtë Strategji.

Ministria e Drejtësisë në rolin e institucionit përgjegjës për hartimin dhe monitorimin e politikave strategjike në fushën e drejtësisë ka ndjekur procesin e hartimit Strategjia Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit 2024 – 2030, Planin e Veprimeve dhe Pasaportën e Treguesve, të cilat janë ideuar në përputhje të plotë me strategjinë e BE-së “Për të drejtën e viktimave 2020 – 2025”.

Strategjia ka parashikuar masa konkrete, të cilat targetojnë viktimat e krimit dhe synojnë fuqizimin e tyre nëpërmjet bashkëpunimit institucional që viktimat të mund të raportojnë krimin, të marrin pjesë në procedimin penal, të kërkojnë kompensim si dhe rikuperimin e tij sa më shpejt.

